



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0479

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE “Es Industry” sh.p.k., me seli në Prishtinë, kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me autovetura për nevojat e KPSH-së -Ritender” me numër të prokurimit 616-23-4972-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK)-Komuna e Prishtinës, më 05/09/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “Es Industry” SH.P.K. me nr. 2023/0479, e datës 10/07/2023, vendimi lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me autovetura për nevojat e KPSH-se-Ritender”, me numër të prokurimit 616-23-4972-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK)-Komuna e Prishtinës, Vërtetohet.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 19.05.2023, Komuna e Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë, ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 12.06.2023. Me datë 19.06.2023, ka publikuar B58 njoftimin mbi vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me autovetura për nevojat e KPSH-së - Ritender” me numër të prokurimit 616-23-4972-1-2-1.

OE ankues “Es Industry” sh.p.k., me datën 26.06.2023, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 30.06.2023, AK - Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues, si dhe ka vërtetuar vendimin e autoritetit kontraktues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Es Industry” sh.p.k., me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit për aktivitetin e prokurimit të sipër shënuar me datë 10.07.2023, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0479.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Autoriteti Kontraktues (AK) ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës është 50,000.00 €

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 25.07.2023, me raportin e ekspertizës. AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me 26.07.2023, ka deklaruar se pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq OE ankues nuk është deklaruar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim me nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 12 qershor 2023, ka rekomanduar që:

- Refuzohet si e pa bazuar ankesa e “Es Industry” sh.p.k., me seli në Prishtinë.
- Të mbetet në fuqi vendimin e AK-së i datës 19.06.2023 (*njoftim për anulim të procedurës së prokurimit*).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Es Industry” sh.p.k., me seli në Prishtinë.

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenet 7, 28, 59 dhe 62 të LPP-së duke e eliminuar OE ankues përkundër që ka ofertuar me autoambulancë që tejkalon

specifikimet teknike.

Rrethanat e çështjes

Në dosjen e tenderit të publikuar nga AK, Aneksi 1- Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ndër të tjera janë paraqitur edhe specifikimet teknike si vijon: Vëllimi i motorit – 2000cm³ dhe Fuqia: 130 PS.

Në njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 19.06.2023, AK ka konstatuar se ne mungesë të OE-ve të përgjegjshëm anulon aktivitetin e prokurimit. Më tej në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar është dhënë arsyetimi si vijon: OE “Es Industry” SH.P.K. në ofertën e tij të dorëzuar nuk i plotëson kushtet sipas specifikimit teknik të dhënë në Aneksin I të DT për autoambulance si në vijim: Vëllimi i motorit është kërkuar të jete 2000 cm³, ndërkaq, OE “Es Industry” SH.P.K ka ofruar vëllimin e motorit me 2179 cm³. Dhe, Fuqia e motorit është kërkuar të jete 130 ps., ndërkaq, OE “Es Industry” SH.P.K ka ofruar fuqinë e motorit 136 ps.

Sipas shkresave të lëndës, OE ankues nuk ka kërkuar sqarime nga AK gjatë fazës së sqarimeve shtesë konform nenit 53 të LPP-së. Poashtu, nuk është dorëzuar kërkesë për rishqyrtim në lidhje me dokumentet e tenderit sikurse përcaktohet me nenin 108/A të LPP-së. Në këtë aktivitet të prokurimit vetëm OE ankues ka dorëzuar ofertë.

OE ankues së bashku me tenderin ka dorëzuar edhe disa dokumente që paraqesin specifikimet teknike të mjetit të ofertuar.

Fillimisht është dorëzuar dokumenti -5 Movano_Cargo Catalogue, ku në faqen 2 është nënvizuar nga OE ankues modeli me karakteristikat: 2.2 Diesel 103 kW (140 PS); -dokumenti “16 Katalogu i vulosur e i nënshkruar” përgatitur nga OE i nënshkruar dhe vulosur në të cilin shënohen karakteristikat: Vëllimi ne ccm³ :2179ccm dhe Fuqia min : 100 KW -136PS -dokumenti - “18 Movano_Cargo Catalogue me specifika të nënvizuara”, ku në faqen 2 janë nënvizuar nga OE ankues karakteristikat: 2.2 Diesel 103 kW (140 PS).

Referuar vendimit të AK-së, datë 29.06.2023, rezulton, se AK ka trajtuar ankesën e OE ankues ku ka vendosur që të refuzojë pretendimet e OE ankues, me arsyetimin si në vijim:

“[...] Duke u referuar te pretendimet si me sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7, 28, 59 dhe 62 të LPP si dhe nenin 37 të RRPP. Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me date 29.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Lidhur me pretendimin e parashtruesit: fillimisht duhet cekur që në raportin vlerësues të datës 19.06.2023 është evidentuar se komisioni i vlerësimit ka gjetur se në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur asnjë tender të përgjegjshëm. Rrjedhimisht me date 19.06.2023

Autoriteti Kontraktues ka nxjerre njoftimin mbi vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Ky vendim si i tillë gjen mbështetje në nenin 43 paragrafin 43.5 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik është përcaktuar se "Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të

anulohet nëse asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm. Sa i përket ofertës së parashtruesit, sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar bazuar në të gjeturat e komisionit vlerësues, parashtruesi përmes ofertës së tij nuk i plotëson kushtet sipas specifikimit teknik në Aneksin 1 të DT për arsye se "vëllimi i motorit është kërkuar të jete 2000 cm³ ndërsa parashtruesi ka ofruar vëllimin e motorit me 2179 cm³" si dhe "fuqinë e motorit është kërkuar të jete 130 ps ndërsa parashtruesi ka ofruar fuqinë e motorit 136 ps".

Nga dosja e tenderit në Aneksin 1 - Specifikimet teknike të detyrueshme ndër të tjera është përcaktuar se vëllimi i motorit duhet të jete 2000 cm³ ndërsa fuqi e motorit duhet të jete 136 PS. Shih në vijim: Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme Autoambulance - Specifikat teknike: Vëllimi i motorit- 2000cm³, Fuqia: 130 PS. Për parashtruesin nuk është aspak kontestues fakti që ai ka ofertuar veturën me vëllim të motorit 2179cm³ dhe me fuqi 136 PS. Pra as vet parashtruesi nuk e konteston faktin se nuk ka ofertuar sipas specifikave teknike të përcaktuara me aneksin 1 të DT. Pretendimi i parashtruesit është artikuluar ashtu që autoambulanca e ofertuar nga ai është më e avancuar sesa ajo që është përcaktuar me specifikat e DT. Megjithatë parashtruesi nuk ka ofertuar asnjë argument, dëshmi apo prove për të mbështetur pretendimin e tij. Nuk ekziston asnjë dilemë që specifikat teknike janë hartuar nga njësi kërkuese në mënyrë profesionale dhe në përputhje jo vetëm me LPP dhe RRPP por edhe me nevojat e AK. Po të kishte qenë AK i bindur se autoambulanca me vëllim të motorit 2179 cm³ do të ishte më mirë sesa 2000cm³, atëherë do të kishte përcaktuar në specifika teknike 2179cm³ dhe jo 2000cm³

- Ngjashëm edhe sa i përket fuqisë së motorit, po të kishte qenë AK i bindur se motori me fuqi 136PS do të ishte më i përshtatshëm sesa me 130PS, atëherë në specifika teknike do të kishte përcaktuar 136PS dhe jo 130PS. Duhet theksuar që parashtruesi ka pasur mundësi të paraqes kërkesë për rishqyrtim edhe kundër njoftimit mbi kontratë përkatësisht dosjes së tenderit. Me fjale të tjera parashtruesi është pajtuar edhe me specifikat teknike të DT të tenderit dhe nuk ka kontestuar ato asnjëherë as para dhe as pas eliminimit të tij nga aktiviteti i prokurimit. Përtej këtij fakti parashtruesi nuk e konteston as që oferta e tij nuk i plotëson specifikat teknike sipas aneksin 1 të DT. Rrjedhimisht është eliminuar si i papërgjegjshëm. Por meqë parashtruesi ka qenë ofertuesi i vetëm në këtë aktivitet të prokurimit, Autoriteti Kontraktues ka vendosur për të anuluar aktivitetin e prokurimit në tërësi. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për piken I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nën paragrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nën paragrafin d) të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik. Për piken III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Bazuar në të thënat me sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.”

Përgjigje në pretendimin ankimor

Eksperti sqaron se çështja kontestuese është vëllimi dhe fuqia e motorit. Në lidhje me vëllimin e motorit është fakt i njohur se vëllimi i motorit të një automjeti llogaritet përmes formulës së thjeshtë të matematikës. Vëllimi i motorit llogaritet në metra kubik (m^3) ose centimetra kubik (cm^3) duk pas të njohur numrin e cilindrave të motorit, diametrin e pistonit në cilindër dhe lartësinë e pistonit në cilindër. Është evidente se në shumicën e rasteve në varësi të prodhuesve dhe modelit automjetet kanë vlera të ndryshme të vëllimit të motorit dhe zakonisht vlera rrumbullakohet me kufirin e sipërm shembull: 1,896 në 1.9; 1,498 në 1.5; 1,968 në 2.0; 2179 në 2.2; 2,461 në 2.5 etj.

Më tej, në lidhje me fuqinë e motorit, sipas dokumenteve të prezantuara nga OE ankues ekzistojnë dallime (mospërputhje) në mes të vlerës së fuqisë së paraqitur në broshurat e prodhuesit dhe broshurën e përgatitur nga OE ankues, konkretisht në broshurat e prodhuesit fuqia e motorit të mjetit të ofertuar është 103 kW (140 PS) ndërsa në broshurën e përpiluar nga OE ankues është 100kW-136PS.

Specifikimet teknike të paraqitura nga AK janë fikse (nuk ka minimum apo maksimum) në pikat e pretenduara.

Nga siç është paraqitur me lartë, OE ankues nuk ka kërkuar sqarime në lidhje me specifikimet e dhëna, përkatësisht nuk ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim lidhur me specifikimet teknike, rrjedhimisht ka dorëzuar ofertë duke u pajtuar me kushtet dhe kriteret e paraqitura në dosjen e tenderit.

Në lidhje me argumenti e paraqitur nga OE ankues se autoambulanca e ofertuar është me e avancuar dhe se sipas testimeve laboratorike shpenzon më pak se modelet me specifikat e paraqitura nga AK, eksperti sqaron se OE ankues nuk ka prezantuar asnjë provë që dëshmojnë këtë pohim.

Neni 59, paragrafi 3 i LPP-së parashikon shprehimisht se: AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme, pretendimi ankimor është i pabazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar se në raportin e ekspertizës së tij.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik.

- Përfundim -

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe

natyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 6, si dhe 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues nisët gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplícit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - ES INDUSTRY SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: